



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KORÇË

Korçë, më 20.12.2021

VENDIM

Nr. 20 datë 20/12/2021

“PËR DHËNIE SHITESE PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR”

Bazuar në ligjin 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, në nenin 5 të ligjit 7703 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.429, datë 12.09.2002 “Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore”, pasi shqyrtoi propozimin e paraqitur nga Kryesia, Këshilli i Qarkut Korçë,

VENDOSI:

1. Ti propozojë Këshillit të Ministrave dhënien e shtesës të pensionit të posaçëm shtetëror:
 - Thodhoraq Guri Vaso, lindur në Korçë në 15.09.1941
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e financës, zhvillimit ekonomik e shërbimeve.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KESHILLIT TË QARKUT

ANA VERUSHI

Konc. Gjergji Kristo

Sekretari i Këshillit të Qarkut: Bashkim Muço





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KORÇË

RELACION

Për Përfitim të pensionit të posaçëm shtetëror

Për Z. Thodharaq (Tedor) Vaso

Në datën 25/11/2021, pranë Këshillin e Qarkut Korçë, ka paraqitur kërkesën për ti propozuar Këshillit të Ministrave caktimin e një shtese pensioni të posaçëm shtetëror mbi pensionin që i takon nga sigurimet shoqërore, z. Thodharaq Guri Vaso.

Nga dokumentacioni që i ka bashkëlidhur kërkesës rrezulton se kërkuesi i përmbush kriteret ligjore të përcaktuara në VKM Nr. 429, Datë 12.9.2002 “Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore” që Këshilli i Qarkut Korçë ti propozojë Këshillit të Ministrave caktimin e një pensioni të posaçëm shtetëror.

I lindur në Korçë më 15.09.1952, z. Thodharaq Vaso iu bashkua ekipit të Skënderbeut por shumë shpejt u aktivizua edhe me ekipin kombëtar në shumë ndeshje ku edhe spikati. Ka qenë 15 vjet me ekipin e Partizanit dhe Skënderbeut, 10 vjet futbollist i Kombëtares së Shqipërisë si dhe 50 vjet trajner dhe publicist futbollist. Ka 36 ndeshje ndërkombëtare nga të cilat 18 janë me ekipin kombëtar. Më poshtë po citojmë disa nga titujt dhe meritat e z. Thodharaq Vaso:

- I cilësuar si “Futbollisti i Shekullit” për Korçën nga anketimet e KF Skënderbeu (viti 1999)
- Fitues i anketës pesë futbollistët më të mirë për vitin 1967 nga loja me Republikën Federale Gjermane.
- Në 90 vjetorin e Shoqërisë Korçare “Vllazëria” i akordohet Medalje e Artë “Për Merita të Shquara” nga Zv/ministri z. Kreshnik Tartari.
- Në 100 vjetorin e Shoqërisë Korçare “Vllazëria”, Bashkia Korçë i akordon “Emblemën e Artë të Bashkisë”, së bashku me H. Mosi, P. Strugji, P. Evro, T. Nikolla dhe L. Shehu.
- Medalje nga Federata Shqiptare e Futbollit për rezultate të larta me ekipet ndërkombëtare.
- Medalja e Meritës nga Klubi i Futbollit Partizani me rastin e 70-vjetorit të klubit.
- Titullin “Kalorësi i Urchërit të Skënderbeut” të akorduar nga Presidenti i Republikës.
- Titulli “Ambasador i Paqes” nga Organizata ndërkombëtare.

Z. Thodharaq (Tedor) Vaso i përmbush parashikimet e nenit 5 pika b të ligjit 7703 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”.

Kërkesa përmban gjeneralitetet, e kërkuesit dhe është e shoqëruar me dokumentat, si vijojnë:

- Fotokopjen e letërnjoftimit elektronik dhe certifikatën e gjendjes civile;
- Vërtetim nga Sigurimet Shoqërore për rrasën e pensionit;
- Kopjet e noterizuara të dokumentave që vërtetojnë meritat e veçanta si titujt, medaljet, urdhërat etj;

Dokumentacioni i paraqitur është konform VKM Nr.429, datë 12.09.2002 "Per kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posacme shtetërcë dhe të shtesave të pensioneve të posacme shtetërore".

KRYETARI I KËSHILLIT TË QARKUT

ANA VERUSHI

Konc.: Gj. Kristo

